



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT**

**Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 201802058/7**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2019

**Lënda :**     *Rekomandim për përmirësimin e kushteve të jetesës të vajzave të shtetasës Kristina Didi.*

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

**SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM**

**Z. ARIAN KRAJA**

**TIRANË**

*Për dijeni:*

**BASHKISË MALLAKASTËR**

**ZOTIT AGRON KAPLLANAJ**

**MALLAKASTËR**

I nderuar zoti Kraja,

Më lejoni, që nëpërmjet këtij komunikimi, të ndaj me Ju problematikën, e trajtuar nga institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me rastin e familjes së shtetasës Kristina Didi.

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit është paraqitur ankesa nga kryetari i Bashkisë Mallakastër, për problematikat e shtetasës Kristina Didi.

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr. 8454 datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, Avokati i Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes, së personit të interesuar ose të dëmtuar.

Në fshatin Fratër, Mallakastër jeton znj.Kristina Didi, 37 vjeç, nëna e dy fëmijëve, përkatësisht 11 vjeç dhe 9 vjeç. Ajo është banore e Bashkisë Tepelenë, fshati Luftinjë, por për arsye të problematikave të gjakmarrjes është vendosur në një banesë të rrënuar në vendlindjen e saj në fshatin Fratër, Mallakastër. Bashkëshorti i saj është duke vuajtur dënimin në institucionet e privimit të lirisë për veprën penale të kryer.

Gjithashtu, Bashkia Mallakastër, informon, se në zbatim të vendimit nr.955, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar, për shkak të kushteve ekstremisht të vështira social ekonomike, ka përfshirë këtë familje në skemën e ndihmës ekonomike nga fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike, ku masa që përfiton ajo është 3600 (tremijë e gjatëqind) lekë në muaj.

Nisur nga shqetësimi i ngritur nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Bashkia Mallakastër, institucioni i Avokatit të Popullit, në mbështetje të pikës 1, të nenit 60, të Kushtetutës si dhe, ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën e këtij institucioni.

Në shkresën zyrtare me nr. K5/B1-2 prot., datë 21.11.2018, institucioni i Avokatit të Popullit kërkoi informacion nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për këtë problematikë të përhershme të familjes Didi.

Në përgjigje të shkresës zyrtare me nr.6709/1prot., datë 11.12.2018, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale informoi, se Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Fier dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Gjirokastër janë institucionet përgjegjëse, të cilat do të trajtojnë rastin në fjalë, mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe do të informojnë për çfarë do të konkludojnë.

Në shkresën zyrtare me nr.1467. prot., Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Gjirokastër informoi se, nga verifikimi i realizuar në Sistemin Elektronik të Ndihmës Ekonomike, znj.Kristina Dida banore në fshatin Luftinjë, Bashkia Memaliaj, në strukturën familjare përbëhet nga katër anëtarë dhe është përfituese e skemës së Ndihmës Ekonomike prej muajit mars të vitit 2018, në masën prej 4860 (katërmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekë, në përputhje me vendimin nr.955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” dhe udhëzimit nr.4, datë 17.2.2017, të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë “Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”, të ndryshuar.

Gjithashtu, në shkresën zyrtare me nr.481/1 prot., Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Fier, informoi se, nga verifikimi në terren së bashku me administratorin shoqëror të Bashkisë Mallakastër, konstatuan si vijon:

- shtetësja Didi, së bashku me dy vajzat e saj minorene, prej pesë vitesh janë larguar nga banesa në fshatin Lutfinjë, Tepelenë, për shkak se bashkëshorti i zonjës është përfshirë në një konflikt për arsye pronësie, ku ka kryer një vrasje, për të cilën është duke vuajtur dënimin në institucionet e privimit të lirisë;
- për dy vite, kjo shtetase ka jetuar në shtëpinë e prindërve të saj në fshatin Fratar;
- gjatë verifikimit në terren, është konstatuar se kjo shtetase jeton në kushte të mjerueshme në një dhomë të një banese gati në shembje pranë prindërve të saj, për të cilën nuk paguan qira.
- të ardhurat e saj sigurohen vetëm nga pagesa e Ndhmës Ekonomike, nga Bashkia Mallakastër, nga fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike.

Në vazhdimësi, ky institucion informoi edhe mbi gjendjen e rënduar psikologjike të kësaj shtetase për sigurinë e vajzave të saj, pasi familja e viktimës nuk ka pranuar pajtim midis familjeve.

Nga vlerësimi i treguesve të mësipërm, punonjësit e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Fier e kanë këshilluar këtë shtetase për vendosjen e vazjave në institucionet e përkujdesit social, deri në përmirësimin e kushteve social-ekonomike të saj, si dhe marrjen e masave për të transferuar vendbanimin nga fshati Luftinjë, Bashkia Memaliaj, në njësinë administrative Fratar, Bashkia Mallakastër.

Gjithashtu, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, Bashkia Mallakastër po menaxhon rastin për ofrimin e shërbimeve psikologjike nga psikologjia e shkollës, ku vajzat edukohen. Në vijim, rasti do të monitorohet edhe nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, Bashkia Mallakastër edhe nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier.

Në përgjigjen zyrtare, dhënë me shkresën me nr.7532/2, datë 11.12.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, informoi se strukturat dhe shërbimet e specializuara të luftës kundër krimeve të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë dhe Fier, për çështjen në fjalë kanë marrë masa për:

- evidentimin dhe mbajtjen në kontroll të konfliktit të lartpërmendur, garantimin e jetesës dhe të shëndetit të znj. Didi dhe fëmijëve të saj,

parandalimin e kryerjes së veprave penale të hakmarrjes dhe gjakmarrjes në dëm të familjes të kësaj shtetase;

- bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacioneve edhe me strukturat e tjera shtetërore vendore e rajonale, si dhe me drejtues së Bashkisë Mallakastër, për rritjen e sigurisë publike në vendbanimin e kësaj familjeje si dhe në shkollën 9-vjeçare “Gjok Doçi”, në fshatin Fratar, ku edukohen dy vajzat të kësaj shtetase.

Për sa më sipër, vlerësojmë punën e kryer nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Fier dhe Drejtoria Vendore e Policisë të Shtetit Gjirokastrë, për masat konkrete të ndërmarra në përputhje me legjislacionit në fuqi.

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe në zbatim të parimit të interesit më të lartë të tyre, për garantimin e zhvillimit të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe gëzimin e një jetese të shëndetshme e pa privime, institucioni i Avokatit të Popullit shpreh shqetësimin, se masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse nuk janë të mjaftueshme për të përmirësuar kushtet ekstremisht të vështira ekonomike (të ardhurat e familjes me tre anëtarë, një adult dhe dy minorene janë 3600 (tremijë e gjatëqind) lekë në muaj dhe banesa ku jetojnë është jashtë çdo standardi minimal për të jetuar).

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës shtetërore.

Ndaj, referuar parashtrimin të mësipërm si dhe duke marrë shkas nga promovimi i rasteve të suksesit, që Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka publikuar gjerësisht në rrjetet sociale<sup>1</sup>, për çështjen në fjalë,

## **REKOMANDOJMË:**

1. Krijimin e mundësive për të siguruar mjete dhe forma efikase për të ndihmuar në garantimin e mirëqenies së vajzave të shtetases Didi, për të dalë nga varfëria ekstreme. Shteti dhe shoqëria duhet t’u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e saj duke marrë masa konkrete për rehabilitimin e banesës së familjes Didi.

---

<sup>1</sup> Konkretisht bëhet fjalë për ndërtimin e shtëpive për familjet në varfëri ekstreme, p.sh. të familjes së Euglent Xhabaftit në Bulticë të Vaqarrit.

2. Institucionet përgjegjëse, qoftë në nivel qendror, ashtu edhe në nivel vendor duhet të bashkëpunojnë dhe të nashkërendojnë ndërmjet tyre, si dhe organizata ndërkombëtare, ojf, vendase apo të huaja për realizimin e projekteve në këtë drejtim.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi e, në vijim të na informoni për qëndrimin Tuaj ndaj tij.

**K O M I S I O N E R**

**Nejla PEKA**